

“ T.T.A ALBA-LAM shpk

SHËNIME

PËR PASQYRAT FINANCIARE TË SHOQËRISË

MBYLLUR MË 31.12.2019

I. Informacion i përgjithshëm

Natyra e aktivitetit

Shoqëria “T.T.A ALBA-LAM” shpk është regjistruar në Rregjistrin Tregtar si person juridik me vendim të Gjykatës së Shkallës Parë Tiranë Nr.4364 datë 25.04.1994 , Identifikohet me Numer Identifikimi te Personit te Tatueshem (NIPT) J62110001L.

Objekti i veprimtarisë është : shërbim hotelerie ,shërbime pastrimi mbeturinash urbane, punime metalike & alumini & druri ,punime ndertimi , ,transport ndërkombetar etj.

Adresa aktuale e selisë është Rruga“Urani Pano “ Nd.3,H.1 Tiranë

II. Përbledhje e politikave të përgjithshme kontabel

a. Kuadri kontabel

Pasqyrat financiare për vitin 2018 janë hartuar në përputhje me Ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit në fuqi .

b. Parimet bazë për përgatitjen e Pasqyrave Financiare

- Pasqyrat financiare janë hartuar individuale .
- Janë përgatitur në bazë të parimit : Të drejtat dhe detyrimet e konstatuara.
- Monedha raportuese është LEKE , e cila është edhe monedha funksionale e shoqërisë.

c. Politikat dhe vlerësimet kontabël

- Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në matjen fillestare me kosto historike dhe vlerësimin e mëparshëm me kosto të amortizuar , instrumentat financiar me vlerë të drejtë , dhe sipas rasteve bazuar në SKK.
- Transaksionet në monedhat e huaja janë përkthyer në LEKE me kursin e këmbimit në datën e transaksionit . Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në mbyllje të ushtrimit janë përkthyer në lekë me kursin e këmbimit të fundvitit të Bankes së Shqipërisë.Diferencat përfshihen në fitime/humbje të periudhës. Aktivet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj vlerësohen e raportohen me kursin historik të monedhës së huaj në datën e transaksionit.
- Llogaritë e arkëtueshme janë vlerësuar dhe përfshirë në Pasqyrat Financiare me vlerën e drejtë.
- Inventaret në datën e mbylljes janë vlerësuar dhe përfshirë në Pasqyrat Financiare me koston e blerjes apo prodhimit .
- Të ardhurat financiare që përshijnë interesa nga llogaritë bankare, fitime nga diferenca kursi në këmbimet , dhe shpenzimet financiare që përshijnë interesa të paguara të kredive dhe humbje nga këmbimet valutore , janë paraqitur në Pasqyrën e Performancës me metodën e kompesimit për vlerën neto.
- Aktivet afatgjata materiale janë vlerësuar me koston e amortizuar. Një ndërtesë e ndërtuar herët e blerë është rivlerësuar dhe regjistruar në Hipotekë. Ndërtesat e tjera dhe trualli janë paraqitur me kosto në pajtim me SKK.



“ T.T.A ALBA-LAM shpk

- Për llogaritjen e amortizimit për AAGJM është zgjedhur metoda e llogaritjes me norma fikse në % mbi vlerën kontabël, të cilat paraqiten në vijim :

Emërtimi	Baza e amortizimit	Norma e amortizimit %
- Ndërtesa	Vlera kontabël	5%
- Instalime të përgjithshme,	Vlera kontabël	5 %
- Makineri e pajisje	Vlera kontabël	20 %
- Mjete transporti	Vlera kontabël	20 %
- Pajisje të tjera e orendi zyre	Vlera kontabël	20 %
- Pajisje informatike	Vlera kontabël	25%
- AA jomateriale	Vlera kontabël	15%

- Për hartimin e Pasqyrave Financiare, menaxhimi ka bërë vlerësime, gjykime, e supozime të arsyeshme për aplikimin e politikave kontabël përgjithësisht në pajtim me SKK, për raportimin e vlerave të shifrave të paraqitura në rubrikat e Pasqyrave Financiare.

III. Shënime për zërat e Pasqyrave Financiare

A.I. Aktivet afatshkurtëra

I .Aktive monetare Leke

Aktivitet monetare të shoqërisë përbëhen nga likujditete në llogaritë bankare dhe në arkë. Mjetet monetare në monedhë të huaj janë rivlerësuar me kursin zyrtar të këmbimit në fund të vitit sipas Bankës së Shqipërisë, dhe diferencat janë përfshirë në Pasqyrën e Performancës.

Aktive Monetare	31/12/2019	31/12/2018
Mjete në banka	21,030,159	41,207,407
Mjete monetare në arkë	3,809,550	675,470
Totali LEKE	24,839,709	41,882,877

3.Të drejta të arkëtueshme Lekë

Janë vlerësuar dhe raportuar me vlerën e drejtë. Përfaqësojnë të drejta të arkëtueshme ndaj klientëve të krijuara gjatë viteve të shkuara dhe gjatë vitit 2019.

<i>Nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>	31/12/2019	31/12/2018
3.1.Të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit		
Klientë për mallra dhe shërbime	56,514,021	58,925,528
Totali LEKE	56,514,021	58,925,528
3.4 Të tjera të arkëtueshme	31/12/2019	31/12/2018
Parapagime të dhëna për furnizim materialesh	2,000,020	2,000,020
Tatim mbi fitimin (teprica kreditore)	216,699	6,008,447
Shteti-TVSH për t'u marrë(teprice kreditore)	2,530,142	1,301,214



“ T.T.A ALBA-LAM shpk

Teprice Taksë doganore e TVSH në Doganë		70,128
Huadhenie Afatshkurter	2,468,400	
Totali LEKE	7,215,261	54,287,383

4. Inventarë

Janë vlerësuar dhe raportuar me kosto, në pajtim me SKK4. Përfaqësojnë :

<u>4.1 Lëndë të para dhe material të konsumueshme</u>	<u>31/12/2019</u>	<u>31/12/2018</u>
Materiale të para & ndihmëse për punime ndërtimore	7'699'939	7,989,190
Ushqime lënde e parë & ndihmëse Hotel Opera	295,918	358,545
Totali LEKE	7,995,858	8,347,735

Gjendja e tyre në fund të vitit 2019 është ulur për vlerën 351,877 lekë , vlerë e cila ka kaluar në shpenzimet e periudhës së bashku me blerjet e vitit aktual.

5. Shpenzime të shtyra

Janë vlerësuar dhe raportuar me kosto, në pajtim me SKK4. Përfaqësojnë :

<u>5.1 Shpenzime të shtyra</u>	<u>31/12/2019</u>	<u>31/12/2018</u>
Shpenzime të periudha të ardhshme		
Projekt arkitektonik për ndërtim objekti(hoteleri)	8,112,000	8,112,000
Totali LEKE	8,112,000	8,112,000

Në këtë zë shoqëria ka përfshirë të gjitha shërbimet e faturuara nga furnitorët por që lidhen me shërbime të periudhave të ardhshme. Njohja e tyre është bërë bazuar në realizimin e kontratës apo shërbimit të faturuar. Elementi kryesor i përfshirë në këtë zë është Projekti arkitektonik për ndërtimin e një objekti(hoteleri). Shoqëria për vitin 2017 ka deklaruar vlerën si më sipër në librin e blerjes si dhe në FDP dhe ka qenë e paraqitur tek aktivet si parapagime të dhëna ndaj furnitorëve , gjatë vitit 2018 furnitori ka stornuar faturën për parapagimin dhe kjo vlerë vitin 2018 dhe ne vazhdim derisa të realizohet definitivisht projekti është kontabilizuar si shpenzim i periudhave të ardhshme.

A.II. Aktive afatgjata

<u>7.1 Aktive afatgjata financiare</u>	<u>31/12/2019</u>	<u>31/12/2018</u>
Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit	235,375,000	235,375,000
Totali LEKE	235,375,000	235,375,000

Vlerën **235,375,000** lekë vlerë e investimit në aksionet e zotëruara në shoqërinë “ Qumështi Ajka “ sha , të vlerësuara me vlerën në datën e transaksionit.

8. Aktive afatgjata materiale

Gjatë viti 2019 shtesat në aktive janë paraqitur me koston e tyre. Në vijim është tabela përmbledhëse e gjendjes së Aktiveve Afatgjata dhe të Amortizimit të tyre.



“ T.T.A ALBA-LAM shpk

Përshkrimi	31.12.2018	Shtesa	Paksime	31.12.2019
a. Vlera me kosto				
8.1 Truall	107,267,858	57,091,955	0	164,359,813
8.2 Ndërtesa	392,406,668	105,454,735	0	497,861,403
8.3 Makineri & pajisje	15,630,119	180,535	77,000	15,733,654
8.4 Mjete transporti	29,198,685	6,707,800	0	35,906,486
8.5 Të tjera install.kompjuter. etj	62,194,906	24,802,875	0	86,997,781
Totali	606,698,237	194,237,900	77,000	800,859,137
b. Amortizim i akumuluar				
8.1 Truall	0	0	0	0
8.2 Ndërtesa	58,576,943	7,612,153	0	66,189,096
8.3 Makineri & pajisje	13,809,832	366,519	65,750	14,110,601
8.4 Mjete transporti	25,381,667	1,434,185	0	26,815,852
8.5 Të tjera insta.konpj.orendi	30,865,138	6,347,439	0	37,212,577
Totali	128,633,580	15,760,296	65,750	144,328,126
c. Vlera kontabël e mbetur				
8.1 Truall	107,267,858	0	0	164,359,813
8.2 Ndërtesa	333,829,725	0	0	431,672,307
8.3 Makineri & pajisje	1,820,287	0	0	1,623,053
8.4 Mjete transporti	3,817,019	0	0	9,090,634
8.5 Të tjera insta.konpj.orendi	31,329,768	0	0	49,785,204
Totali	478,064,657	0	0	656,531,011

Aktive totale të blera gjatë viti 2019 janë 194,237,900 Lekë ,

Aktive totale të shitura gjatë viti 2019 janë 77,000 Lekë ,

- **Zëri Truall** , është shtuar gjatë vitit 2019 pasi shoqëria me datë 01.02.2019 ka blerë 810.25 m2 truall në total me vlerë **57,091,955 Lekë** , e cila ka shtuar aktivet dhe janë vlerësuar me kosto .Pronat janë të rregjistruara në ZVRPP Tiranë në pronësi të shoqërisë. Këto kontrata për vitin 2019 janë shlyer me urdhërshirim bankar në vlerën 30,304,355 Lekë pjesa tjetër prej 26`787`600 Lekë është paraqitur në zërin detyrime afatshkurtra ndaj furnitorëve në fund të periudhës .
- **Zëri Ndërtesa** përfshin katër ndërtesa tre ekzistuese dhe një të blerë në vitin 2019 në pronësi të shoqërisë.
 - a) Një ndërtesë shtatë katëshe në Tiranë , që ndodhet në Rrugën “Mihal Duri”Tiranë ka hyrë nga blerja në vitin 2011. Kjo ndërtesë është rivlerësuar nga shitësi dhe është pranuar rivlerësimi edhe nga blerësi. Është e regjistruar me akt pronësie në ZVRPP me vlerën e rivlerësuar 216,300,000 lekë. Teprica e rivlerësimit është përfshirë në kapitalet e veta 100,996,000 lekë sipas SKK5. Gjithashtu vlera prej 61,294,465 Lekë në fund të periudhës ka kaluar nga zëri “Aktive Afatgjata Materiale në Proces”, krijuar nga situacionet e punimeve si vetëfurnizim nga vetë shoqëria gjatë viteve 2013-2019 për rikonstruksioni e objektit dhe vënien në funksion për hotel në zërin “Ndërtesa” .Për vitin 2019 nuk është llogaritur amortizim pasi objekti ka përfunduar në fund të vitit 2019 dhe pritet të vihet në shfrytëzim në fillim të vitit 2020. Në aktive është pëfshirë me kosto të amortizuara 242,881,131 (VI kontabël).



“ T.T.A ALBA-LAM shpk

b) Një ndërtesë që ndodhet në Rrugën “Urani Pano” Tiranë , është ndërtuar nga vetë shoqëria dhe është regjistruar me kosto me vlere fillestare 170,502,920 lekë, ndërtesë e cila është vënë në shfrytëzim e përfunduar me 01.01.2016 vlere e mbetur e pasqyruar në aktive është 139,484,798 lekë.

c) Një ndërtesë që ndodhet në Rrugën “Urani Pano” Tiranë , është blerë nga shoqëria me datë 01.04.2018 dhe është regjistruar me kosto me vlere fillestare 5,603,748 lekë, ndërtesë e cila është vënë në shfrytëzim në fuksion të hotelerisë me 01.04.2018 , dhe për këtë ndërtesë shoqëria ka bërë ndërhyrje duke e rikonstruktuar atë ,krijuar nga situacionet e punimeve si vetëfurnizim nga vetë shoqëria gjatë vitit 2019 dhe vlere prej 3,083,340 Lekë do t'i shtohet vlerës fillestare të kësaj ndërtese .

Vlera e mbetur e pasqyruar në aktive është 8,229,448 lekë.

d) Apartament me sipërfaqe 166.6 M²i cili ndodhet në Rrugën “Ismail Qemali” Tiranë , blerë më 17.10.2019 regjistruar në ZVRPP Tiranë me vlerë kontabël **41,076,930 Lekë** , i cili ka shtuar aktivet ,vlerësuar me kosto fillestare, shlyer 100% me urdhërxhirim bankar. Për vitin 2019 nuk është llogaritur amortizim.

- **Makineri pajisje** janë pakësuar për vlerën fillestare 77,000 Lekë , dhe janë shtuar për vlerën fillestare 180,535 Lekë dhe janë deklaruar në bilanc me kosto të amortizuar (me vlerë kontabël) të shënuar më sipër.
- **Mjete transporti** nuk janë pakësuar për vitin 2019 dhe janë shtuar për vlerën 6,707,800 lekë dhe janë përfshirë në aktive me vlerë kontabël të mbetur si më sipër . Për këtë shtesë është llogaritur amortizim sipas datës së hyrjes në shfrytëzim.
- **Të tjera AAGJM** përbëhen nga: Pajisje zyre , pajisje informatike, orendi , pajisje hotelerie etj. Gjatë vitit 2019 janë shtuar për vleren kontabël 24,802,875 lekë vlerësuar me kosto. Për këtë shtesë është llogaritur amortizim sipas datës së hyrjes në shfrytëzim . Janë përfshirë me kosto të amortizuar (vlerën kontabël) 49,785,204 leke.

8.6 AAGJM material në proces

8.7 Aktive në proces është pakësuar në fund të vitit 2019 ka kaluar në zërin “Aktive Afatgjata Materiale” siç e kemi sqaruar dhe me sipër , ku ndër vite ka përfaqësuar vlerën e situacionuar për rikostruksionin e ndërtesës rruga “Mihal Duri” Tiranë me destinacion hoteleri e cila është trajtuar si vetëfurnizim.

10 **Aktive afatgjata jo materiale** në Bilanc janë përfshirë me kosto të amortozuar (vlerën kontabël 252,534 Lekë . Norma e amortizimit e përlllogaritjes është 15% mbi vlerën e mbetur .

Aktive afatgjata materiale në Bilanc janë përfshirë me vlerën kontabël ,(Koston e marrjes – amortizimin) Janë në pronësi të shoqërisë. Përbërja , vlere fillestare , amortizimi i akumuluar ,amortizimi vjetor , shtesat dhe pakësimet , dhe vlere kontabël për vitin 2019 sipas grupeve janë paraqitur në Pasqyrën e Aktiveve Afatgjata Materiale ,bashkëlidhur Pasqyrave Financiare.

Vlerësimet dhe pasqyrimet në pasqyrat financiare janë bërë në pajtim me SKK 5 dhe 2 .

Amortizimi është llogaritur në përputhje me rregullat dhe normat fiskale të përcaktuara në Ligjin “Për Tatimin mbi të ardhurat “i ndryshuar.

B.1 DETYRIMET

Detyrime afatshkurtra përfshijnë të gjitha detyrimet që shoqëria ka ndaj palëve të treta, të cilat pritët që të shlyhen brenda 12 muajve nga data e pasqyrave financiare. Përmbledhja e detyrimeve është si në tabelën në vijim:

1 .Detyrime afatshkurtra	31/12/2019	31/12/2018
Furnitorë mallra, produkte dhe shërbime	41,124,027	14,986,093



“ T.T.A ALBA-LAM shpk

Të pagueshme ndaj punonjësve	2,108,874	652,662
Të pagueshme për Sigurimet Shoqërore(dhjetor 2019)	308,899	278,197
Të pagueshme për TAP(dhjetor 2019)	13,134	6,501
Të pagueshme për Tatim Fitimi (viti 2019)	447,048	0
Të tjera të pagueshme Tax fjetje në hotel(dhjetor 2019)	59,080	85,960
Totali	44,061,061	16,009,413

B.II. Detyrimet afatgjata

<u>5.4 .Detyrime afatgjata</u>	<u>31/12/2019</u>	<u>31/12/2018</u>
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	34,778,773	29,372,455
Furnitorë për active afatgjata	98,312,210	98,312,210
Totali	133,090,983	127,684,665

Shoqëria në fund të vitit 2019 nuk ka asnjë detyrim ndaj institucioneve të kredisë apo bankave të nivelit të dytë .

B.III. Kapitali dhe Rezervat , përbëhet

	<u>31/12/2019</u>	<u>31/12/2018</u>
11. Kapitali i nënshkruar	655,000,000	655,000,000
12.13 Rezerva nga rivlersimi	84,787,457	84,787,457
14.1 Rezerva ligjore	30,500,000	30,500,000
14.3 Rezerva të tjera	516,051	516,051
15 Fitim i pa shpërndarë	16,208,542	16,208,542
16 Fitim i ushtrimit	32,671,299	4,506,437
Totali	819,683,349	791,518,486

- Kapitali i nënshkruar , në vitin 2019, nuk ka pësuar ndryshime nga viti i kaluar . Kapitali përbëhet nga një kuotë dhe zotërohet 100 % nga ortak i vetëm z.Illir Mata.
- Rezerva nga rivlerësimi 84,787,457 Lekë përfaqëson vlerën e rivlerësimit të ndërtesës Rruga“Mihal Duri”e amortizuar me kuotën e amortizimit të llogaritur , vlerë e cila kalon në fitime të paspërndara. Për vitin 2019 nuk është llogaritur amortizim sepse ende nuk është vënë në shfrytëzim.
- Rezerva ligjore ,Rezerva të tjera , janë mbartur nga vite të kaluara pa pësuar ndryshime .
- Rezerva të tjera 16,208,543 Lekë përfaqëson kuotën e amortizimit të llogaritur për tepicën e rivlerësimit të ndërtesës Rruga“Mihal Duri”Tiranë , e cila përbën fitim të paspërndarë dhe nuk shpërndahet gjatë jetës së ndërtesës.
- Fitimi i vitit ushtrimor 2019 , pasqyron vlerën neto të fitimit pas zbritjes së tatimit mbi fitimin, të llogaritur në Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve .

IV Caktimi i fitimit neto realizuar në vitin 2018 .

Fitimi neto i realizuar në vitin ushtrimor 2018 për 4,506,437 Lekë .

Me vendim të asamblesë së ortakut të vetëm Nr.70 Datë 28.06.2019 , është caktuar si vijon;

- Shpërndarje për dividend në vlerën 4,506,437 lekë



“ T.T.A ALBA-LAM shpk

Për shpërndarjen e dividendit është llogaritur dhe paguar tatim mbi dividendin në masën 8% e barabartë me 360,515 lekë.

C. PASQYRA PERFORMANCËS (TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET)

I.Të Ardhurat

Shoqëria ka realizuar të ardhura nga shërbimi i hotelerisë ,nga shërbimi i dhënies në shfrytëzim të sallës së konferencës ,i shitjes së produkteve në bar-restorant ,nga shërbimi i pastrimit të mbeturinave urbane, i shitjes së produkteve të gatshme , i situacioneve të ndërtimit të objektit “Godina e Bashkisë Mirditë”, i situacioneve të ndërtimit të objektit “Palestra Lezhë”, të ardhura nga Vendim Gjyqate Nr.2383 datë 11.11.2015, shitjes së AQT-ve si dhe situacionet e punimeve për Prodhim AAGJ Materiale .

Shitjet neto janë të paraqitura në tabelën në vijim :

<i>I. Të ardhurat kryesore</i>	<i>31/12/2019</i>	<i>31/12/2018</i>
1. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit		
1.1 Të ardhura shitja e produkteve	1,649,134 Lekë	2,000,653 Lekë
1.2 Të ardhura nga shërbime pastrim qyteti	5,068,957 Lekë	2,576,231 Lekë
1.3 Të ardhura nga situacin punime ndërtimi	13,935,508 Lekë	37,406,188 Lekë
1.4 Të ardhura nga Shërbim Hotelerie (6%)	53,093,974 Lekë	52,903,979 Lekë
<u>1.5</u> Të ardhura nga Shërbim Sallë Konference,bar-restoran në Hotel(20%)	4,729,203 Lekë	4,885,030 Lekë
Totali	78,476,776 Lekë	99,772,081 Lekë

2. Të ardhura nga puna e kryer nga njësia ekonomike

Në këto të ardhura përfshihen Prodhim i Aktiveve Afatgjata nga vetë shoqëria(trajtuar si vetëfurnizim) , Vlerë e situacioneve të punimeve për prodhim AAGJM në process për ndërtesën Rr.”Mihal Duri”Tiranë dhe për ndërtesën në Rrugën “Urani Pano” Tiranë.

<i>Të ardhura nga puna e kryer nga njësia ekonomike</i>	<i>31/12/2019</i>	<i>31/12/2018</i>
1.3.Prodhim i aktiveve afatgjata nga vetë shoqëria	24,674,634 Lekë	22,714,300 Lekë
Totali	24,674,634 Lekë	22,714,300 Lekë

1.4.Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Në këto të ardhura përfshihen shitja e aktiveve të qëndrueshme gjatë viti 2019.

<i>Të ardhura të tjera</i>	<i>31/12/2019</i>	<i>31/12/2018</i>
1.3.Shitje e AQT-ve	11,253 Lekë	4,972,178 Lekë
1.4Të ardhura të tjera nga Vendim Gjyqate dt11.11.2015	8,000,000 Lekë	
Totali	8,011,253 Lekë	4,972,178 Lekë



“ T.T.A ALBA-LAM shpk

Evidentimi i diferencave ndërmjet të ardhurave në PASH dhe FDP

Analiza dhe rakordimi i shitjeve

Viti 2019

➤ Shitje të deklaruara gjatë vitit 2019 në FDP	105,042,197 Lekë
➤ Të ardhurat e deklaruara në PASH	111,168,425 Lekë
Diferenca	6,126,228 Lekë

Së pari : Diferenca prej 1,878,588 Lekë përfaqson Autongarkesën e TVSH-së për komisionet e rezervimit për Hotel Opera marrë nga Booking.com pasqyruar në Librin e Shitjes & Librin e Blerjes dhe në FDP për vitin 2019 por për të mos dubluar të ardhurat dhe shpenzimet në mënyrë fiktive nuk është paraqitur në PASH

Së dyti : Të ardhura të tjera nga aktiviteti është vlera prej 8,000,000 Lekë , kalur në llogari të shoqërisë me urdhërshirim bankar 29.05.2019 tek Credins Bank nga studio përmbarrimore”Besnik Dokushi” bazuar në Vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë Nr.2383(390) Dt.11.11.2015 me palë të paditur Inspektoriat Ndërtimor Urbanistik Kombëtar që për efekt të dëmspërblimit për dëmet pasurore të shkaktuara nga zbatimi i vendimit nr.10 datë 17.12.2009 tek objekti Hotel Opera , vlerë e cila nuk është deklaruar në FDP por vetëm në P. A .SH .

Së treti: Të Ardhura nga Interesa Bankare 5,762 lekë janë të pasqyruara në PASH por jo në FDP Tatime.

II. Materialet e konsumuara paraqiten si më poshtë vijon:

III. Shpenzime për aktivitetin kryesor	31/12/2019	31/12/2018
5.1 Lëndë të para dhe materiale të konsumueshme	13,089,627	27,925,544
5.2 Të tjera shpenzime	13,018,008	43,064,906
6.1 Shpenzime për paga personeli	12,845,500	15,374,868
6.2 Sigurime shoqërore e shëndetsore	2,133,565	2,562,165
8. Shpenzime amortizimi AAGJM & Jo materiale	16,028,809	17,263,865
9. Shpenzime të tjera shfrytëzimi	14,855,834	15,066,757
10.Shpenzime financiare	635,408	851,909
Totali	72,606,751	122,110,014

Shpenzimet përbëhen si vijon :

5.1 Përfshihen gjithë shpenzimet për kostot e materialeve të para, materialeve ndihmëse për realizimin e të ardhurave të shënuara më sipër , si për produkte të prodhuara nga vetë shoqëria, situacione pastrimi , situacione ndërtimi, situacione ndërtimi AAGJ për vehte, ushqime e material ndihmese, të grupuara si vijon .

5.2 Të tjera shpenzime të shfrytëzimit , përfshihen gjithë shpenzimet për realizimin e të ardhurave të shënuara më sipër.Kosto materiale e shërbimeve të përdorura karburante & gaz , vajra lubrifikante,riparime e mirëmbajtje mjete transporti ,makineri, furnitura për shërbimet në ndërtim, shpenzime ujë, energji elektrike,telefon ,internet,shpenzime për furnizim& vendosje nga të tretë , materiale pastrimi, kancelari,etj.

6.1 Pagat në shpenzime janë përfshirë për pagën bruto sipas listëpagesave dhe janë llogaritur sipas niveleve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore.

6.2 Shpenzimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore janë përfshirë në shpenzimet për atë pjesë që paguan punëdhënësi, dhe janë llogaritur mbi pagën bruto në kufijtë e pagës minimale të punës , dhe pagës maksimale të sigurimit .

8.Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale

8. Amortizimi **16,028,809 lekë** është llogaritur në përputhje me udhëzimin “Për tatimin mbi të ardhurat” sipas normave fiskale.
- Amortizim ndërtesa është llogaritur mbi vlerën e mbetur me 5 %
 - Amortizim makineri pajisje është llogaritur mbi vlerën e mbetur me 20 %
 - Amortizim mjete transporti është llogaritur me 20 % mbi vlerën e mbetur
 - Amortizimi për pajisje zyre dhe informatike është llogaritur 20 % & 25 % mbi vlerën kontabël,
 - Amortizim AAGJ Jomateriale është llogaritur linear 15 %
9. *Shpenzime të tjera* **14,855,834 lekë**, të grupuara sipas natyrës përfshijnë ;
- Tarifa për Siguracione për mjetet, sigurim oferte, sigurim prone etj347,068 Lekë
 - Shërbime ekspertiza, noteri, kontabilitet, certificate etj6,805,483 Lekë
 - Reklame, publicitet59,325 Lekë
 - Shpenzime telefoni, internet975,568 Lekë
 - Shpenzime bankare680,852 Lekë
 - Taksa e tarifa tatimore801,446 Lekë
 - Taksa e tarifa Vendore.....4,995,092 Lekë
 - Gjoba179,751 Lekë
 - Vlera kontabël e mjeteve të transportit të shitura11,250 Lekë

12.1 Shpenzime financiare

- Pasqyrojnë Interesa të paguara për huatë bankare	26,032	610,491
- Humbje nga kursi i këmbimit	609,376	241,418
- Totali	635,408	851,909

Totali i Shpenzimeve II+III	72,606,751 Lekë	122,110,014 Lekë
------------------------------------	------------------------	-------------------------

A. Totali i të ardhurave rezulton	111,168,425	127,483,252
B. Totali i shpenzimeve rezulton	72,606,751	122,110,014
14. Fitimi para tatimit i llogaritur	38,561,674	5,373,238
C. Shpenzime të panjohura	707,491	405,439
D. Fitimi i tatueshëm rezulton	39,269,165	5,778,677
15., Tatimi mbi fitim me shkallë 15 % llogaritet të jetë	5,890,375	866,802
16. Fitimi i vitit (Fitimi neto	32,671,299	4,506,436
• Keste të tatim fitimit paraprak gjatë vitit janë paguar	5,443,327	6,875,249
• Detyrim Tatim Fitimi për t'u paguar rezulton	447,048	0
• Teprice debitore Tatim Fitimi më 31/12/2019 rezulton :	216,699	6,008,447

“ T.T.A ALBA-LAM shpk

Evidentimi i diferencave ndërmjet shpenzimeve në PASH dhe FDP

17.Rakordimi i blerjeve me FDP me shpenzimet në PASH

Analiza dhe rakordimi i blerjeve të aktiveve	Viti 2019
Importe	437,154
Blerje brenda vendit	70,649,501
Blerje pa TVSH	105,625,248
Autongarke TVSH ne Blerje me te drejte kreditimi	1,878,588
Shuma e blerjeve të raportuara me FDP	178,590,491
Nga kjo	
Aktive afatgjata Materiale (minus)	-144,317,614
Materiale të konsumuara blere me FDP (minus)	-32,103,848
Autongarkesa e TVSh ne blerje (minus)	-1,878,588
Diferenca midis fatures doganore dhe koston reale te blerjes (minus)	-290,441
Totali i Shpenzimeve sipas FDP	- 178,590,491

Diferenca 0

Shpenzime sipas Pasqyrës së PASH	Viti 2019
Materiale të konsumuara blere me FDP	32,103,848
Pakësimi i gjendjes së magazinës (blerë me FDP në vitin 2018)	351,878
Shpenzime të pa raportuara në librin e blerjes	40,150,998
(Pagat,sig.shoq, amortizimi, vl.kontabel e AQT-ve të shitura ,Taksa vendore ,Taksa e Tatime Shteti, interesa overdraft, shërbime bankare,humbje nga këmbimi valuator etj)	
Totali i Shpenzimeve sipas PASH	72,606,751

Pasqyra e fluksit të parasë dhe Pasqyra e Lëvizjeve në Kapital , janë hartuar në përputhje me SKK.

Nuk ka ngjarje pas datës që do të ishte e nevojshme të paraqiteshin si rregullime ose informacione shtesë në këto pasqyra financiare.

Tiranë , më 31.03.2020

